

Njoftim vendimi

Postuar në: 20/09/2023



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga Rezarta Schuetz kryesuese, Ina Rama relatores, Albana Shtylla, Natasha Mulaj, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 54/2021, datë 24.09.2021 që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 415, datë 07.07.2021.

Në përfundim të gjykit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 415, datë 07.07.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 20.09.2023.